

## **RAPORTI I DHËNIES SË SIGURISË NGA AUDITUESI I PAVARUR**

**Mbi Pasqyrat Financiare të përgatitura  
për qëllim të zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë  
“PERXHOLA”shpk**

RAPORT I DHËNIES së SIGURISË i AUDITUESIT të PAVARUR .....	1
Pasqyra e lëvizjeve të Kapitalit të Nënshkruar të Shoqërisë .....	4
Pasqyra e Financimeve/Tërheqjeve të kryera nga Ortakët .....	5
Pasqyra e levizjeve në llogaritë e Kapitaleve të Veta të Shoqërisë.....	6
1. Të Dhëna të Përgjithshme .....	7
2. Vendime ne lidhje me Kapitalet e Veta .....	7
3. Financimet/Tërheqjet e ortakëve .....	7
4. Vendimarrja e Asamblesë me qëllim të njohjes së humbjes në kapital.....	7
5. Politikat Kontabël për pasqyrimin e Kapitaleve të Veta .....	8

## RAPORT I DHËNIES SË SIGURISË NGA AUDITUESI I PAVARUR

Drejtuar :

**ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË “PERXHOLA” SH.P.K”**

### Qëllimi i Angazhimit:

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me vendim datë 07.12.2022 më ka angazhuar si auditues ligjor, për të verifikuar dhe për të dhënë siguri të arsyeshme mbi përgatitjen dhe paraqitjen me vërtetësi të veprimeve kontabël, në funksion të zmadhimit të kapitalit të nënshkruar të Shoqërisë, sipas parashikimeve të paraqitura në pikën 2 të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme datë 07.12.2022, si dhe përcaktimin e vlerës së kapitalit të zmadhuar, si rezultat i ngjarjes së parashikuar në Vendimin (dhe pikën) e sipërcituar. Për këtë qëllim, ne kemi rishikuar Pasqyrat Financiare të përgatitura për qëllim të analizimit të levizjeve të kapitalit të shoqërisë, të cilat përfshijnë ; (i) *Pasqyrën levizjeve të Kapitalit të Nënshkruar të Shoqërisë* për periudhën që mbaron më 31 Dhjetor 2021 dhe periudhën që mbaron më 30 Nëntor 2022, (ii) *Pasqyrën e Financimeve/tërheqjeve të kryera nga Ortakët*, për periudhën 21 Gusht 2019 deri më 31 Dhjetor 2019 si dhe periudhën 01 Janar 2020 deri më 21 Dhjetor 2020, (iii) *Pasqyrën e Levizjeve në llogaritë e Kapitaleve të Veta të Shoqërisë*.

### Kriteret

Si bazë për angazhimin e verifikimit të levizjeve të kapitalit, unë kam përdorur Standardet Kombëtare të Raportimit Financiar, Ligjin Nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si dhe Ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Unë jam njohur dhe kam verifikuar të gjitha Vendimet e Asamblesë së Shoqërisë që lidhen me autorizime të veprimeve me pasojë ndryshime që prekin çdo llogari të kapitaleve të veta të shoqërisë.

### Përgjegjësia e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në përputhje me kriteret e sipërpërmendura. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat financiare.

Drejtimi është përgjegjës për respektimin e të drejtave të ortakëve, kryerjen e llogaritjeve dhe pasqyrimit e drejtë të kuotave që i takojnë ortakëve të shoqërisë në momentin e zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit.

Drejtimi është përgjegjës për respektimin e modaliteteve ligjore dhe statutore për thirrjen e Asamblesë me rend dite ndryshimin e kapitalit.

### Përgjegjësia jonë

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në procedurat e kryera, të shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare të përgatitura për këtë qëllim. **Ne e kryem auditimin në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (SNAS 3000) “Angazhime të dhënies së Sigurisë që ndryshojnë nga Auditimet apo rishikimet e Informacioneve Financiare Historike”** dhe standardet e tjera që lidhen me çështjen në fjalë.

Këto standarde kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej procedurat e nevojshme për të siguruar një nivel sigurie të arsyeshme që informacionet e përgatitura nga drejtimi i Shoqërisë për kapitalet e veta janë të vërteta dhe të sinqerta, në të gjitha aspektet materiale si dhe cdo informacion tjetër kontabël në funksion të cështjes.

**Procedurat e kryera nga ana jonë për këtë angazhim përfshijnë:**

1. Verifikimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me vendimarrjet e ortakëve për autorizimin e veprimeve në lidhje me llogaritë e Kapitaleve të Veta.
2. Verifikimin e përputhshmërisë së shifrave në Pasqyrën e Kapitaleve të Veta me ato të Pasqyrave Financiare, të vitit ushtrimor mbyllur më 31 Dhjetor 2021, identikisht edhe për periudhën ushtrimore të mbyllur më 30 Nëntor 2022 (paraprake).
3. Verifikimin e financimeve apo tërheqjeve të mundshme që mund të jenë kryer nga Ortakët e Shoqërisë, dhe që lidhen qartësisht dhe vetëm me kapitalet e veta, nga data e Vendimit më të fundit të zbatuar (i datës 23.12.2020) deri në datën e nënshkrimit të këtij Raporti.
4. Verifikimin e llogaritjeve për vlerën e kuotave të Ortakëve, si efekt i zmadhimit të Kapitalit të Nënshkruar, nëse pranohet ky Raport.

**Konkluzioni:**

1. Bazuar në çmuarjen kontabël me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare për periudhën që mbyllet më datë 31.12.2021, administrimi i Shoqërisë ka konkluduar se vlera 2,295,573 lekë, që lidhet me detyrime tatimore të njohura dhe të regjistruara si të tilla gjatë vitit 2021, (si rrjedhojë e rivlerësimeve tatimore të kryera nga organet përkatëse), të mos i përfshijë në rezultatin e periudhës ushtrimore 2021, vit kur është bërë edhe njohja e tyre.
2. Referuar Standardit Kombëtar të Kontabilitetit SKK 1, duke qënë se vlera e konsideruar “humbje” nuk lidhet me periudhën ushtrimore të mbyllur më 31.12.2021 (gjatë të cilës kjo vlerë është njohur dhe është regjistruar), por lidhet me periudha më të hershme (më shumë se tre vjet më parë nga njohja), kjo shumë nuk është përfshirë në rezultatin e vitit 2021, por është njohur në retrospektivë.  
Element tjetër i rëndësishëm për njohjen në retrospektivë të shumës së mësipërme është fakti se vlera e humbjeve nga periudha të mëparshme ushtrimore të njohura në Pasqyrat Financiare 2021, është materiale në krahasim me fitimin e regjistruar nga aktiviteti ekonomik i Shoqërisë për të njëjtën periudhë.  
Ortaku i Vetëm kërkon që në këtë Raport të shprehet dhe të merret në konsideratë, që kjo humbje do të mbulohet nëpërmjet zvogëlimit të kapitalit të nënshkruar.
3. Përgjatë periudhës 23 Dhjetor 2020 (data më e fundit e vendimit që autorizon ndryshime në vlerën e kapitalit të nënshkruar) e deri në datën e hartimit të këtij Raporti, nuk ka patur asnjë veprim të lidhur me kapitalin e nënshkruar, që do të kërkonte edhe ndryshime në regjistrim.

Por konkludojmë se ka patur disa vendime që lidhen me llogari të tjera të kapitaleve të veta, si më poshtë:

- me Vendimin datë 18.06.2021, fitimi i vitit ushtrimor 2020 është transferuar plotësisht në llogarinë e Rezervave të kapitalit
  - me Vendimin datë 23.06.2022, i gjithë fitimi i vitit ushtrimor 2021 së bashku me një pjesë nga Rezervat e kapitalit, është shpërndarë në formën e dividendit
4. Propozohet që në këtë Raport të merret në konsideratë zmadhimi i Kapitalit të Nënshkruar të shoqërisë me fonde rezervat, në vlerën 4,295,573 lekë.
  5. Bazuar sa më lart, vlera neto që rezulton si shtesë e Kapitalit të Nënshkruar të Shoqërisë, është 2,000,000 Lekë (-2,295,573 + 4,295,573).

Pas vendimarrjes së ortakëve për realizimin e rritjes së kapitalit, vlera e kuotës së kapitalit për Ortakun e Vetëm dhe përqindja në kapitalin e shoqërisë do të rezultonte si më poshtë:

Ortaku	Nr. i kuotave	Vlera e kuotës	% në kapital
Përparim Golli	1	582,000,000	100%
<b>Totali</b>	<b>1</b>	<b>582,000,000</b>	<b>100%</b>

**MIGELA XHANI**  
 EKSPERT KONTABEL  
 TIRANE

AUDITUESE LIGJORE

Tiranë më, 28.12.2022

**PERXHOLA SH.P.K**

**Shënime mbi Pasqyrat Financiare, për qëllim të zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë**

---

**PASQYRA E LËVIZJEVE TË KAPITALIT TË NËNSHKRUAR TË SHOQËRISË**

**Për periudhën 31 Dhjetor 2021 deri më 21 Dhjetor 2022**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera e Kapitalit të Nënshkruar sipas Pasqyrave Financiare 31.12.2021</b>	<b>Shuma neto që do të përdoret për zmadhimin e kapitalit</b>	<b>Shuma e Kapitalit të Nënshkruar pas realizimit të zmadhimit të kapitalit</b>
Kapitali i nënshkruar	580,000,000	2,000,000	582,000,000

## PASQYRA E FINANCIMEVE/TËRHEQJEVE TË KRYERA NGA ORTAKËT

Nga data 21 Dhjetor 2020 deri më 21 Dhjetor 2022

<b>Periudha 21.12.2020-31.12.2021</b>	<b>Financime në ALL</b>	<b>Tërheqje në ALL</b>
Përparim Golli	-	-
Totali	-	-
<b>Periudha 01.01.2022-21.12.2022</b>	<b>Financime në ALL</b>	<b>Tërheqje në ALL</b>
Përparim Golli	-	3,029,249
Totali	-	<b>3,029,249</b>

## PASQYRA E LËVIZJEVE NË LLOGARITË E KAPITALEVE TË VETA TË SHOQËRISË

Për periudhën 31 Dhjetor 2020 deri më 21 Dhjetor 2022

	Kapitali i Nënshkruar	Rezerva	Humbjet nga periudhat e kaluara ushtrimore	Diferenca nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja.	Fitim(humbja) e periudhës	Totali
	.	.			.	.
<b>Pozicioni Financiar më 31.12.2020</b>	<b>580,000,000</b>	<b>30,001,898</b>	-	-	<b>997,217</b>	<b>610,999,115</b>
<b>Lëvizje për periudhën (01.01.2021-31.12.2021)</b>						
Njohje e humbjeve nga periudha ushtrimore të kaluara			(2,295,573)			(2,295,573)
Zmadhimi i Rezervës nga fitime të periudhave ushtrimore të kaluara		997,217			(997,217)	0
Shpërndarje Fitimi						
Rezultati i periudhës					2,325,707	2,325,707
<b>Totali i lëvizjeve për periudhën (01.01.2021-31.12.2021)</b>	<b>0</b>	<b>997,217</b>	<b>(2,295,573)</b>	<b>-</b>	<b>1,328,490</b>	<b>30,134</b>
	<b>580,000,000</b>	<b>30,999,115</b>	<b>(2,295,573)</b>	<b>-</b>	<b>2,325,707</b>	<b>611,029,249</b>
<b>Pozicioni Financiar më 31.12.2021</b>						
<b>Lëvizje për periudhën (01.01.2022-21.12.2022)</b>						
Mbulimi i humbjes nga Kapitali	(2,295,573)		2,295,573			0
Zmadhimi i Kapitalit nga rezervat	4,295,573	(4,295,573)				0
Rezultati i periudhës						
Shpërndarje Fitimi		(703,542)			(2,325,707)	(3,029,249)
<b>Totali i lëvizjeve për periudhën</b>	<b>2,000,000</b>	<b>(4,999,115)</b>	<b>2,295,573</b>	<b>-</b>	<b>(2,325,707)</b>	
<b>Pozicioni Pozicioni Financiar më 21.12.2022</b>	<b>582,000,000</b>	<b>26,000,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>608,000,000</b>



## 1. Të Dhëna të Përgjithshme

PERXHOLA sh.p.k (më poshtë "Shoqëria") është një shoqëri e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 18.06.1999 dhe është pajisur me NUIS J921080080.

Aktiviteti i Shoqërisë është : *Në fushën e ndërtimeve civile industriale, turistike, bujqësore deri në 2 kate dhe mbi 2 kate me kompletime dhe instalime të nevojshme, ndërtime ujësjellësa e kanalizime, punime mbrojtjeje, sistemime hidraulike, punime dheu, sistemime, taracime terrenesh, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash etj. Tregtim material ndërtimi, elektrike, konfeksione të ndryshme, fruta, perime, produkte bujqësore, blegtorale me shumicë dhe pakicë, import, eksport brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luejtshme e të paluejtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektivit të Shoqërisë që nuk ndryshon aktivitetin parësor të saj dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.*

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë aktualisht është 580,000,000 lekë dhe zotërohet nga ortaku i vetëm z. Përparim Golli.

Administratori i Shoqërisë është z. Përparim Golli.

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Rruga Donika Kastrioti, nr. 4, Pallati nr. 14, Shkalla nr. 1, Apartamenti nr. 21.

## 2. Vendimet që lidhen me ndryshime të Kapitalit të Nënshkruar

Veprimi më i fundit i zbatuar në lidhje me ndryshimin e kapitalit të nënshkruar, daton më 23.12.2020. Ky veprim autorizon zmadhimin e kapitalit të nënshkruar, nëpërmjet transferimit të fondeve nga llogaria "Rezervat e kapitalit".

## 3. Financimet/tërheqjet e Ortakëve

Për periudhën Dhjetor 2020-Dhjetor 2022, rezultojnë tërheqje të ortakëve në formën e dividendit rrjedhojë e të cilave është zvogëlimi i kapitaleve të veta të Shoqërisë.

## 4. Vendimarrja e Asamblesë për qëllim të njohjes së humbjeve në kapital

Me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare për periudhën që mbyllet më datë 31.12.2021, administrimi i Shoqërisë ka konkluduar se vlera 2,295,573 lekë, (humbje nga vitet ushtrimore 2017-2019), nuk duhet përfshirë në rezultatin e vitit 2021 por rregullimi të bëhet në retrospektivë dhe i ka kërkuar zyrës së kontabilitetit ta trajtojë të tillë gjatë hartimit të pasqyrave Financiare 2021.

Referuar Standartit Kombëtar të Kontabilitetit SKK 1, duke qënë se vlera e konsideruar e “humbje” është materiale dhe e krijimi i saj nuk lidhet me periudhën më të fundit ushtrimore të mbyllur më 31.12.2021, kjo shumë nuk është përfshirë në rezultatin e vitit 2019, pasi SKK 1 rekomandon që rregullimi të bëhet në retrospektivë.

Kur gabimet materiale të periudhave kontabël të mëparshme korrigjohen në retrospektivë, efekti është sikur gabimi të mos kishte ndodhur kurrë. Informacioni krahasues i periudhave kontabël të mëparshme korrigjohet për efektin e gabimit. Nëse një gabim është bërë gjatë një periudhe kontabël para periudhës krahasuese ose gjatë periudhave kontabël, edhe më të hershme, tepricat e çeljes së aktiveve, detyrimeve dhe fitimeve të pashpërndara apo kapitalit të periudhës aktuale korrigjohen. (SKK 1)

Ky Raport (dhe Vendimi i Asamblesë pas miratimit të tij), synon të çertifikojë llogaritjen e korigjimit në retrospektive, lidhur me efektin e tij në kapitalet e veta të Shoqërisë, posaçërisht në mbulimin e humbjes nga kapitali i nwnshkruar.

## **5. Politikat Kontabël për pasqyrimin e Kapitaleve të Veta**

### **a. Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare**

Pasqyrat Financiare të shoqërisë janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Ligjin Nr.25/2018 dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të rasteve që përcaktohet ndryshe, nëse ka të tilla.

### **b. Monedha Funktionale dhe me të cilën paraqiten pasqyrat**

Pasqyrat Financiare paraqiten në monedhën vendase ALL (Lek), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e shoqërisë. Informacioni financiar është paraqitur në Lek.

### **c. Huatë**

Huamarrjet nga ortakët maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar, përveçse në rastet kur shoqëria zgjedh që t'i mbajë detyrimet me vlerën e drejtë në fitim ose humbje.